



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË DOKUMENTACIONIT
BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr 1259/7 Prot.

Tiranë, më 27.09.2021

RELACION

MBI VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Drejtuar:

**Z. OLSIAN ÇELA
PROKUROR I PËRGJITHSHËM**

Nga:

**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË DOKUMENTACIONIT,
BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

I nderuar Z. Prokuror i Përgjithshëm,

Data 11 dhjetor 2021, konsiderohet si përfundimi i mandatit për 3 anëtarë prokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Bazuar në nenin 149/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ju më datë 22.07.2021, nxorrët njoftim për hapjen e procedurës së aplikimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ftuat prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit, duke përfshirë edhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, prokurorët nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të shprehin interesin për të kandiduar për këto vende.

Pas mbarimit të afatit ligjor, rezulton se janë depozituar 5 (pesë) kërkesa, nga prokurorët për të kandiduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga të cilët, 3 (tre) kandidatë konkurojnë për anëtarin nga prokuroritë e shkallëve të para, 1 (një) kandidat për anëtarin nga prokuroritë e apeleve dhe 1 (një) kandidat për anëtarin nga Prokuroria e Përgjithshme.

Kandidati për anëtarin nga Prokuroria e Përgjithshme;

1. **Z. Sokol Stojani**, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, paraqiti kërkesën me nr. Prot. 1259/1, datë 01.09.2021.

Kandidat për anëtarin nga prokurorit e apeleve;

1. **Z. Ludovik Dodaj**, me detyrë prokuror në prokurorinë e apelit Durrës, paraqiti kërkesën me nr. Prot. 1259/4, datë 03.09.2021.

Kandidatët që konkurojnë për anëtarin nga prokuroritë e shkallëve të para janë si më poshtë:

1. **Znj. Deniona Katro**, me detyrë prokurore në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, paraqiti kërkesën me nr. Prot. 1259, datë 23.08.2021.
2. **Z. Zeqir Hoda** me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, paraqiti kërkesën me nr. Prot. 1259/2, datë 02.09.2021.
3. **Znj. Elona Alvora**, me detyrë prokurore në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë, paraqiti kërkesën me nr. Prot. 1259/3, datë 03.09.2021.

- Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të parashikuara nga neni 105 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësië”, janë si vijon:

- a) në kohën e kandidimit, të kenë ushtruar funksionin e prokurorit për të paktën 10 vjet;
- b) në kohën e kandidimit, nuk duhet të jenë drejtues të një zyre prokurorie ose anëtarë të organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata prokurorësh, sindikata prokurorësh etj.;
- c) të jenë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale;
- ç) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- e) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;
- ë) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

-Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për shprehje interesi, në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është si vijon:

- a) jetëshkrimin e përditësuar;
- b) deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkuara rregullisht;
- c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;
- d) një deklaratë individuale të nënshkuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;
- dh) një deklaratë individuale të nënshkuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;
- e) informacion mbi të afermit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afermit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor;
- ë) listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Në mbështetje të nenit 109, pika 1 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësië”, Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka bërë verifikimin e plotësimin të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe

KONSTATOI SE:

- **I. Për kandidatin z. Sokol Stojani**, nga verifikimet e kryera rezultoi,
- Ka ushtruar funksionin e prokurorit prej 28 vjetësh (*Emëruar me Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të datës 29.12.1993*)
 - Është vlerësuar “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale; (*vlerësimet e punës për vitin 2015 dhe vitin 2016*)
 - Nuk ka masa disiplinore në fuqi (*vlerësuar sipas të dhënave personale*);
 - Lidhur me gjendjen gjyqësore të kandidatëve u bënë verifikimet e nevojshme në sistemin e gjendjes gjyqësore që akseson Prokuroria e Përgjithshme, (*bashkëlidhur certifikata elektronike*)
 - Nuk është subjekt në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (*bashkëlidhur deklarata e kandidatit, si dhe Vendimi nr. 81, datë 02.05.2018, i AISSH*).
 - Nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete (*sipas shkresës nr. 4722/13 prot., datë 14.09.2021, të SHISH*).
 - Në kohën e kandidimit, *nuk ka asnjë anëtar të familjes*, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë, *që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar*.
 - Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, që i është bashkëlidhur kërkesës për shprehje interesi, u konstatua se janë dorëzuar në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,
- **II. Për kandidatin z. Ludovik Dodaj**, nga verifikimet e kryera rezultoi,
- Ka ushtruar funksionin e prokurorit prej 38 vjetësh (*Emëruar me Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të datës 29.12.1993*)
 - Është vlerësuar “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale; (*vlerësimet e punës për vitin 2015 dhe vitin 2016*)
 - Nuk ka masa disiplinore në fuqi (*vlerësuar sipas të dhënave personale*);
 - Lidhur me gjendjen gjyqësore të kandidatëve u bënë verifikimet e nevojshme në sistemin e gjendjes gjyqësore që akseson Prokuroria e Përgjithshme, (*bashkëlidhur certifikata elektronike*)
 - Nuk është subjekt në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (*bashkëlidhur deklarata e kandidatit, si dhe Vendimi nr.242, datë 31.05.2021, i AISSH*).
 - Nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete (*sipas shkresës nr. 4722/13 prot., datë 14.09.2021, të SHISH*).
 - Në kohën e kandidimit, *nuk ka asnjë anëtar të familjes*, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë, *që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar*.
 - Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, që i është bashkëlidhur kërkesës

për shprehje interesi, u konstatua se janë dorëzuar në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

➤ **III. Për kandidaten znj.Elona Alvora**, nga verifikimet e kryera rezultoi,

- Ka ushtruar funksionin e prokurorit prej 12 vjetësh (*bashkëlidhur Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 6293, datë 12.10.2009*)
- Në kohën e kandidimit nuk ushtron funksionin e drejtuesit (*verifikuar të dhënat personale*);
- Është vlerësuar “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale; (*vlerësimet e punës për vitin 2015 dhe vitin 2016*).
- Nuk ka masa disiplinore në fuqi (*vlerësuar sipas të dhënave personale*);
- Lidhur me gjendjen gjyqësore të kandidatëve u bënë verifikimet e nevojshme në sistemin e gjendjes gjyqësore që akseson Prokuroria e Përgjithshme, (*bashkëlidhur certifikata elektronike*)
- Nuk është subjekt në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (*bashkëlidhur deklarata e kandidatit, si dhe Vendimi nr. 22, datë 22.01.2021, i AISSH*).
- Nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete (*sipas shkresës nr. 4722/13 prot., datë 14.09.2021, të SHISH*).
- Në kohën e kandidimit, *nuk ka asnjë anëtar të familjes*, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë, *që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar*.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, që i është bashkëlidhur kërkesës për shprehje interesi, u konstatua se janë dorëzuar në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

➤ **IV. Për kandidatin z. Zeqir Hoda**, nga verifikimet e kryera rezultoi,

- Ka ushtruar funksionin e prokurorit prej 23 vjetësh (*Emëruar me Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të datës 24.12.1997*)
- Në kohën e kandidimit nuk ushtron funksionin e drejtuesit (*verifikuar të dhënat personale*);
- Është vlerësuar “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale; (*vlerësimet e punës për vitin 2015 dhe vitin 2016*)
- Nuk ka masa disiplinore në fuqi (*vlerësuar sipas të dhënave personale*);
- Lidhur me gjendjen gjyqësore të kandidatëve u bënë verifikimet e nevojshme në sistemin e gjendjes gjyqësore që akseson Prokuroria e Përgjithshme, (*bashkëlidhur certifikata elektronike*)
- Nuk është subjekt në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (*bashkëlidhur deklarata e kandidatit, si dhe Vendimi nr. 22, datë 22.01.2021, i AISSH*).
- Nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete (*sipas shkresës nr. 4722/13 prot., datë 14.09.2021, të SHISH*).
- Në kohën e kandidimit, *nuk ka asnjë anëtar të familjes*, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë, *që është anëtar në detyrë i Këshillit ose*

kandidat për anëtar.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, që i është bashkëlidhur kërkesës për shprehje interesi, u konstatua se janë dorëzuar në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

➤ **V.** Për kandidaten **znj. Deniona Katro**, nga verifikimet e kryera rezultoi,

- Ka ushtruar funksionin e prokurorit prej 13 vjetësh (*bashkëlidhur Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 5846, datë 29.07.2008*)
- Në kohën e kandidimit nuk ushtron funksionin e drejtuesit (*verifikuar të dhënat personale*);
- Është vlerësuar “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale; (*vlerësimet e punës për vitin 2015 dhe vitin 2016*).
- Nuk ka masa disiplinore në fuqi (*vlerësuar sipas të dhënave personale*);
- Lidhur me gjendjen gjyqësore të kandidatëve u bënë verifikimet e nevojshme në sistemin e gjendjes gjyqësore që akseson Prokuroria e Përgjithshme, (*bashkëlidhur certifikata elektronike*)
- Nuk është subjekt në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (*bashkëlidhur deklarata e kandidatit, si dhe Vendimi nr. 407, datë 24.09.2021. i AISSH*).
- Nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete (*sipas shkresës nr. 4722/13 prot., datë 14.09.2021, të SHISH*).
- Në kohën e kandidimit, *nuk ka asnjë anëtar të familjes*, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë, *që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.*
- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, që i është bashkëlidhur kërkesës për shprehje interesi, u konstatua se janë dorëzuar në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

Përfundime:

Përsa më sipër, bazuar në nenin 109, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u verifikuan kushtet ligjore, dhe pas përcaktimeve të nenit 105, pikat 2 dhe 4, të këtij ligji, rezultoj se 5 (pesë) kandidatët që kanë shprehur interesin, për të konkuruar në vendet vakante, plotësojnë kushtet ligjore për të kandiduar si anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Pas miratimit nga ana juaj, të këtij relacioni, Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, do të shpalli zyrtarisht kandidaturat në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.